



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica
Municipality of Gjakova

DATË/A:	05.06.2012
PËR/ZA/TO:	Kryetarin e Komunës Dr. Pal Lekaj
KOPJE/A/CC:	
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Drejtori z.Ismet Isufi inxh.dip.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Donatorët që kanë ndihmuar në realizimin e projekteve

Në bashkëpunim me Kforin – Cimikun Italian kemi bërë investime në shtruarjen e rruges me zhavor dhe 800 metra kubëza. Vlera e investimeve nga K.K. është 1.500 €, kurse Kfori ka participuar me 12.000 €. Koha e realizimit Tetor – Nëntor 2008.

Është bërë ndërtimi i hangarit për ruajtjen e mekanizmit bujqësor, platoja e silazhit të misrit, dhoma e frigos për ruajtjen e prodhimeve të qumështit, zyrën e stafit dhe aneksi i nyjës sanitare për nevojat e qendrës. Vlera financiare është 93.000 € - bashkëfinancim i Kforit Gjerman Cimic – ut dhe Komunës.

Në vitin 2010 janë ndërtuar 2 Penda për ujitje, 1 Pendë me Ministrinë e Bujqësisë në fshatin Sheremet dhe 1 Pendë në fshatin Ramoc nga Kuvendi Komunal – Gjakovë. Po ashtu janë ndërtuar 5 km kanale të ujitjes në 12 fshatra me investime të Komunës dhe do të ujiten mbi 1500 ha tokë që me vite nuk janë ujitur.

Në vitin 2010 MBPZHR ka bërë subvencionimin e fermerëve në pagesa direkte për lopë qumësstore kanë aplikuar 305 fermer kurse kanë përfituar 275 fermer. Gjithsej numri i krerëve është 2473. Shuma e pagesës 74,190.00 €. Për dele dhe dhi kanë aplikuar 80 fermer dhe kanë përfituar 74 fermer. Gjithsej numri i krerëve 6298. Shuma e pagesës 57,530.00 €.

Është bërë marrëveshje bashkëpunimi për projektin e përbashkët në sektorin e blegtorisë. Në realizimin e këtij projekti është përfshirë një ndihmë prej 90 dhi të produktivitetit të lartë dhe një ndihmë prej 20 mështjerë Hollshtain – Frizis, ku nga pasimi i dhuratave do të përfitojnë 20 familje. Vlera e këtyre projekteve është 18.700 € (20 %) e financuar nga Komuna kurse pjesën tjetër nga Heifer – i. Implementues i këtij projekti është Shoqata “Dushkaja” – Bec. Programi për ngritjen e pemishteve jo më pak se 0.25 ha. Bashkëfinancues janë Komuna e Gjakovës, Intercooperation dhe Fermeri. Vlera e këtij projekti është 2.059 €.

Kfori Hungarez gjatë muajit Qershor, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka dhuruar një sasi të ndihmave për sektorin e Bujqësisë e cila konsiston prej 30 makinave mjelëse, 30 bidonëve për bartjen e qumështit, 150 thasë koncentrat për lopë qumështore dhe 300 ballë sanë – ushqim për bagëti. Ky subvencion është shpërndarë në bazë të listës së propozuar të OJQ – Dushkaja - Bec që veprojnë në territorin e Komunës së Gjakovës. Kjo ndihmë 30 fermerëve ju ka mundësuar që të kenë kushte më të mira për mbajtjen e bagëtisë, për higjienën në Stalla etj.

Në bashkëpunim me Qendrën për punësim dhe Agjensionin e Pyjeve të Kosovës janë mbjellë më se 16 ha me pisha ku sasia e tyre ishte 40000 copë dhe është bërë punësim sezonal i mëse 40 punëtorëve. Koha e realizimit Tetor 2008.

Në muajin Korrik 2010 është bërë bartja e kompetencave nga Ministria e Bujqësisë nëpër Komuna.

Gjendja në këtë sektor nuk është e kënaqshme, sidomos ruajtja e pyjeve dhe pyllëzimi i tyre.

Komuna ka marrë masa për ruajtje më të mirë të pyjeve si pasuri kombëtare.

Këtë vit janë mbjellur rreth 8 ha përkatësisht me 20000 fidane me pishë të zezë.

Në vitin 2010 në bashkëpunim me MPMS dhe Komunën është bërë ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale të Komunës sonë, ku janë punësuar 44 punëtor sezonal. Në këtë projekt Komuna ka participuar më 20 % të shumës kurse pjesën tjetër e ka participuar MPMS. Vlera e projektit është **155,625.00 €**.

Ndihma nga Kfori Italian - Ndërtimi i platos së shtallës për rregullimin e vendit për mbajtjen e Panairit të gjedhit. Vlera e këtij projekti është 30,000 €, ku Komuna ka participuar me 10,000 € dhe Kfori me 20,000 €.

Kfori Italian ka ndërtuar kanalin e ujitjes në fshatin Novosellë ku ju është mundësuar banorëve ujitja e tokave bujqësore. Bashkëfinancues janë Komuna me 20 %. Vlera e këtij projekti është 13,000 €. Koha e realizimit Shtator 2011.

Në vitin 2011 Ministria e Bujqësisë ka ndërtuar Pendën për ujitje në fshatin Brovinë. Vlera e projektit është 80,000 €.

Në vitin 2011 MBPZHR ka bërë subvencionimin e fermerëve në pagesa direkte për lopë qumështore kanë aplikuar 260 fermer kurse kanë përfituar 256 fermer. Gjithsej numri i krerëve është 1944. Shuma e pagesës 58,320.00 €. Për dele dhe dhi kanë aplikuar 54 fermer dhe kanë përfituar 49 fermer. Gjithsej numri i krerëve 5753. Shuma e pagesës 57,530.00 €.

Në subvencionin e grurit kanë aplikuar 483 fermer, kanë përfituar 423 fermer. Gjithsej sipërfaqja e mbjellë me grurë 1926 ha. Shuma e pagesës 192,600.00 €.

Me respekt,